



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

V E N D I M

Nr. 162, Datë 14.04.2021

PËR

VERIFIKIMIN E PLOTËSIMIT NGA KANDIDATI Z. {...}, TË KATËR KRITEREVE TË KANDIDIMIT PËR NGRITJEN NË DETYRË NË GJYKATËN E POSAÇME TË APELIT PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR, PËR POZICIONIN E LIRË TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR. 30, DATË 25.01.2021, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR DHE VIJIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT PËR KRITERET E TJERA LIGJORE TË KANDIDIMIT

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 14.04.2021, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e katër prej kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të kandidatit z. {...}”, përgatitur nga relatorja znj. Marçela Shehu, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 30, datë 25.01.2021, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “dhënies së pëlqimit (ai edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale” dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit,

V Ë R E N

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Me Vendimin nr. 30, datë 25.01.2021, Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) ka vendosur:

*“1. Rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë.....
.....3. Afati i kandidimit është deri më datë 12.02.2021”*

2. Vendimi i Këshillit si më lart për hapjen e procedurës së kandidimit për në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, është publikuar në faqen e tij zyrtare të internetit më datë 26.01.2021.

3. Brenda afatit të kandidimit, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin si më sipër, ka kandiduar gjyqtari z. {...} (më poshtë referuar si kandidati), aktualisht gjyqtar në skemën e delegimit, pranë Gjykatës së Apelit Vlorë deri më datë 05.11.2021. Ndërkohë ky kandidat, më herët ka kandiduar për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 187, datë 28.05.2020 dhe në Gjykatën e Apelit Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 392, datë 07.10.2020, kandidime për këto të fundit për të cilët procedura e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit, të pasurisë dhe figurës, është në proces e sipër.

4. Me Vendimin nr. 77, datë 04.03.2021, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 30, datë 25.01.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, Këshilli ka vendosur:

“1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 30, datë 25.01.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Caktimin e relatorit si më poshtë:

1. Për kandidatin z. {...} - relatore znj. Marçela Shehu.

3. Për kandidatin z. {...}, i cili ka kandiduar më parë për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës dhe në Gjykatën Administrative të Apelit, procedura e verifikimit sa i përket pasurisë dhe figurës që është në proces e sipër për këto kandidime, është e vlefshme edhe për kandidimin e tij për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 30, datë 25.01.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

5. Më datë 04.03.2021, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, në rrugë elektronike, kandidati u njoftua:

- për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit dhe faktin që edhe në këtë procedurë verifikimi relatore e tij do të jetë znj. Marçela Shehu.

6. Kandidati nuk parashtrroi ndonjë pretendim në lidhje me këto fakte.

7. Referuar disponimit të pikës 3, të Vendimit të Këshillit nr. 77, datë 04.03.2021, meqënëse procedura e verifikimit të kriterëve të pasurisë dhe figurës për këtë kandidat është në proces përpara Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ndërkohë që kjo procedurë është përcaktuar nga Këshilli si e vlefshme edhe për procedurën e ngritjes në detyrë të kandidatit në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, kandidati depozitoi rregullisht dokumentacionin e kërkuar të kandidimit, pranë Zyrës së Protokollit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ç’ka nënkupton të drejtën e Këshillit për të vijuar verifikimin me kriteret e tjera ligjore të kandidimit.

8. Sipas pikës 9, të Vendimit të Këshillit nr. 30, datë 25.01.2021, është përcaktuar se: *“Për kandidatin, për të cilin me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor verifikohet plotësimi i kriterëve ligjore të kandidimit sipas shkronjave “a”, “b”, “ç” dhe “d” të pikës 5 të këtij vendimi, fillon procesi i vlerësimit etik dhe profesional:...”*. Ndërkohë, në pikën 5, shkronja “a”, të Vendimit të Këshillit nr. 30, datë 25.01.2021, përcaktohet se: *“Kriteret ligjore që duhet të plotësojë kandidati për t’u ngritur në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar përcaktohen ..., si më poshtë: a) Kandidati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se dhjetë vjet si gjyqtar, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar në fushën e drejtësisë kriminale, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”*. Nga ana tjetër, në shkronjat “b”, “c” dhe “ç”, të pikës 5, të këtij vendimi, përcaktohet se: *“b) Kandidati duhet të japë pëlqimin (ai edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”; c) Kandidati duhet të mos ketë masë disiplinore në fuqi; ç) Kandidati duhet të mos jetë në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”*.

9. Në respektim të vendimit si më lart të Këshillit, sa i përket plotësimit të katër kriterëve formale të sipërpërmendura të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, u administrua informacioni i nevojshëm nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, i cili është përcjellë në rastin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës dhe në Gjykatën Administrative të Apelit.

9.1 Për verifikimin e kriterëve të “përvojës profesionale minimale” dhe atij të “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, me Shkresën nr. 3189/1 prot., datë 13.07.2020, ka përcjellë informacionin dhe dokumentacionin përkatës të administruar për kandidatin z. {...}, siç do të përshkruhet më poshtë.

9.2 Sa i përket kriterit të “përvojës profesionale minimale” dhe pikërisht sa i përket “përvojës specifike profesionale” të kandidatit në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë ku ai ka kandiduar, pra në fushën e të drejtës penale/drejtësisë kriminale, referuar gjykatave ku kandidati ka ushtruar funksionin e gjyqtarit, konkretisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, u administrua informacioni i ardhur nga të dyja këto gjykata në kuadër të procesit të verifikimit të kushteve të kandidimit të z. {...} për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës. Në këtë rast u vlerësua i panevojshëm rikërkimi i informacionit nga këto gjykata, meqënëse informacioni i dërguar nga ato sjell të dhëna pikërisht për përvojën e kandidatit në fushën e të drejtës penale. Konkretisht, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë informacioni i kërkuar është përcjellë me Shkresën nr. 4651/1 prot., datë 17.07.2020, siç do të përshkruhet më poshtë dhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier informacioni i kërkuar është përcjellë me Shkresën nr. 4007/1 prot., datë 16.07.2020, i saktësuar edhe në rrugë elektronike, siç do të përshkruhet më poshtë. Gjithashtu u kërkuar informacion nga Gjykata e Apelit Vlorë ku kandidati është komanduar në skemë delegimi, informacioni i cili është përcjellë në rrugë elektronike, siç do të përshkruhet më poshtë.

II. REZULTATET E VERIFIKIMIT PARAPRAK PËR KATËR KRITERET E KANDIDIMIT

10. Për kandidatin z. {...} u verifikua kriteri i “përvojës profesionale minimale”.

11. “Përvoja profesionale minimale” për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, që gjen reflektim në shkronjën “a”, të pikës 5, të Vendimit të Këshillit nr. 30, datë 25.01.2021, është parashikuar si kriter kandidimi, në nenin 47, pika 2, shkronja b të Ligjit për Statusin. Sipas kësaj dispozite, ky kriter kandidimi përbëhet në vetvete nga dy të tillë, ai për për “përvojën e përgjithshme profesionale minimale” dhe ai për “përvojën specifike profesionale minimale”. Konkretisht në këtë dispozitë të ligjit përcaktohet se: *“b) për pozicionin gjyqtar apeli në Gjykatën e Posaçme të Apelit për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar, magjistrati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se dhjetë vjet si gjyqtar, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale ose si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;”*.

12. Për verifikimin e kandidatit në lidhje me plotësimin e këtij kriteri për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, u mbajt parasysh se kandidati, krahas përvojës së përgjithshme profesionale minimale, duhet të plotësojë edhe përvojën specifike profesionale minimale, pra jo më pak se pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshatshme për pozicionin e lirë, konkretisht në fushën e të drejtës penale.

13. Në lidhje me përvojën e përgjithshme profesionale, në kërkesat për shprehje interesi dhe në jetëshkrimin e dorëzuar nga kandidati, evidentohet se ajo ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2011. Kandidati ka kryer stazhin profesional si gjyqtar në kuadër të vitit të tretë të Shkollës së Magjistraturës në vitet 2010 - 2011 pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Më pas, ai është emëruar përfundimisht gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, ku ka ushtruar funksionin për periudhën 21.12.2011 – 10.02.2017. Nga data 10.02.2017 – 05.11.2020, ka ushtruar funksionin e ndihmës magjistratit të komanduar pranë Gjykatës së Lartë Tiranë. Me vendimin nr. 528 datë 27.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është caktuar gjyqtar në skemën e delegimit për të gjykuar pranë Gjykatës së Apelit Vlorë nga data 05.11.2020 deri me datë 05.11.2021.

14. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidati z. {...}, fillimin në detyrë e ka me Dekretin e Presidentit të Republikës nr. 6689 datë 27.09.2010, ku është emëruar për të kryer stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndërsa me Dekretin e Presidentit të Republikës nr. 7203 datë 21.12.2011, ai është emëruar përfundimisht gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier. Më pas, me Vendimin nr. 14 datë 10.02.2017 të ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë i është akorduar leje 3 vjeçare për të shërbyer si ndihmës magjistrat pranë Gjykatës së Lartë. Me vendimin nr. 33 datë 23.01.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor i është zgjatur komandimi edhe 1 vit për të shërbyer si ndihmës magjistrat pranë Gjykatës së Lartë, ku ka vijuar të ushtrojë funksionin deri me datë 05.11.2020.

Me vendimin nr. 528 datë 27.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është caktuar gjyqtar në skemën e delegimit për të gjykuar pranë Gjykatës së Apelit Vlorë nga data 05.11.2020 deri me datë 05.11.2021.

15. Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, kandidati z. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të

shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 30, datë 25.01.2021, rezulton të ketë mbi dhjetë vjet përvojë të përgjithshme profesionale, si gjyqtar.

16. Në lidhje me përvojën specifike profesionale, në kërkesën për shprehje interesi, kandidati ka deklaruar se ka eksperiencë të mjaftueshme në fushën e të drejtës penale prej më shumë se 5 vjetësh.

17. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton se:

“... z. {...}, fillimin në detyrë e ka me Dekretin nr. 6689, datë 27.09.2010, ku është emëruar për të kryer stazhin profesional pranë kësaj gjykate deri më 21.12.2011.

Në lidhje me sa kërkoni, për periudhën kohore për të cilën kërkohet informacioni për përvojën e gjyqtarit z. {...}, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, nuk disponon urdhra të Kryetarit për ndarjen në dhoma/seksione të gjyqtarëve.

Në mungesë të tyre, bashkëngjitur kësaj shkrese, gjeni në format statistikor, llojet e vendimeve gjyqësore të dhëna nga gjyqtari z. {...}, për periudhën 2010-2011...”.

17.1 Referuar të dhënave të regjistrit të vendimeve civile për vitin 2010 - 2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kandidati z. {...}, referuar objektit të çështjeve gjyqësore, është shortuar dhe ka gjykuar çështje të karakterit administrativ, civil dhe **penal**.

18. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, rezulton se:

“...Gjyqtari {...}, gjatë periudhës që ka ushtruar funksionin e tij në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier ka gjykuar bazuar në urdhrat përkatës të kryetarit të gjykatës për vitin 2012 në seksionin administrativ, në vitin 2013 në seksionin administrativ, në vitin 2014 në seksionin civil, në vitin 2015 në seksionin civil, në vitin 2016 në seksionin civil, në vitin 2017 në seksion civil (deri në komandimin pranë Gjykatës së Lartë)

Gjithashtu theksohet fakti se pavarësisht se gjykata ka qenë e ndarë në seksione, të gjithë gjyqtarët kanë gjykuar me short kërkesa penale dhe kërkesë padi me objekt lëshim urdhër mbrojtje ..”.

18.1 Sipas informacionit të detajuar të përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, në rrugë elektronike, rezulton se:

“...Gjyqtari {...}, gjatë periudhës që ka ushtruar funksionin e tij në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier në periudhat që ka qenë pjesë e trupës gjyqësore të seksionit administrativ, ka gjykuar edhe çështje civile e penale, pra ka gjykuar çështje të karakterit administrativ, civil dhe penal. Konkretisht ka gjykuar 424 çështje penale (kërkesa penale dhe çështje penale themeli)”

18.2 Referuar të dhënave të mësipërme për vitin 2012 - 2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, kandidati z. {...}, ka gjykuar çështje të karakterit administrativ, civil dhe **penal**.

19. Ndërsa, referuar periudhës së ushtrimit të detyrës sipas vendimit nr. 528 datë 27.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor ku është caktuar gjyqtar në skemën e delegimit për të gjykuar pranë Gjykatës së Apelit Vlorë nga data 05.11.2020 deri me datë 08.02.2021 (data kur ka aplikuar për kandidim) rezulton se kandidati z. {...}, ka gjykuar *çështje të karakterit civil dhe penal*.

19.1 Sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata e Apelit Vlorë, në rrugë elektronike me datë 02.04.2021, rezulton se:

“... në Gjykatën e Apelit Vlorë nuk ka ndarje të gjyqtarëve në seksione apo dhoma. Kjo për shkak të numrit gjithmonë të kufizuar të gjyqtarëve.... Për rrjedhojë gjyqtari {...} ka gjykuar çështje të natyrave të ndryshme, pra civile dhe penale”

20. Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, kandidati z. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 30, datë 25.01.2021, rezulton të ketë mbi pesë vjet përvojë specifike profesionale në fushën e të drejtës penale.

21. Për kandidatin z. {...} u verifikua kriteri i “Dhënies së pëlqimit (ai/ajo edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

22. “Dhënia e pëlqimit (ai edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar” si kriter për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, që gjen reflektim në shkronjën “b”, të pikës 5, të Vendimit të Këshillit nr. 30, datë 25.01.2021, është parashikuar në nenin 47, pika 3, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “Për të gjitha pozicionet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, magjistrati duhet të përmbushë edhe kriteret e tjera dhe kushtet e sigurisë, të parashikuara në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, i cili në fakt është një dispozitë referuese e cila referon konkretisht në nenin 48, pika 1 dhe 2 të Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, që përcakton se: “1. Përpara emërimit, kandidatët për gjyqtarë dhe pozicione të tjera në gjykatat kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, kandidatët për prokurorë dhe pozicione të tjera në Prokurorinë e Posaçme, kandidatët për drejtor, zëvendësdrejtor, hetues, oficer të shërbimeve të Policisë Gjyqësore dhe pozicione të tjera në Byronë Kombëtare të Hetimit firmosin deklaratën përkatëse me shkrim për heqjen dorë nga e drejta e tyre për pritshmëri për privatësi (jetë private) në telekomunikimet e tyre dhe në të dhënat financiare, të dhënë në shtojcat B1 e B2 të këtij ligji. Kjo deklaratë firmoset përpara se ata të caktohen me detyrë apo të punësohen. 2. Anëtarët e afërt të familjeve të personave të përmendur në pikën 1 gjithashtu firmosin deklaratën përkatëse për heqjen dorë nga e drejta, të dhënë në shtojcën B3 të këtij ligji, si tregues se i kuptojnë kushtet...”

23. Në lidhje me këtë kriter, në rastin e aplikimit, kandidati ka depozituar:

- Formularin “Vetëdeklarim (i gjyqtarëve dhe prokurorëve)”, Shtojca B, Deklarata 1, plotësuar dhe firmosur rregullisht nga kandidati, z. {...}, i datës 08.03.2021;

24. Sa sipër, rezulton se kandidati, në respektim të përcaktimeve ligjore, ka dhënë pëlqimin e shprehur sipas formularëve përkatëse tip, për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

25. Për kandidatin z. {...} u verifikua edhe kriteri i “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.

26. “Mospasja masë disiplinore në fuqi” si kriter për ngritjen në detyrë edhe në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, që gjen reflektim në shkronjën “ç”, të pikës 5, të Vendimit të Këshillit nr. 30, datë 25.01.2021, është parashikuar në nenin 48, pika 8, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “Vetëm kandidatët të cilët ... nuk kanë masa disiplinore në fuqi, pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë”.

27. Në lidhje me këtë kriter, në rastin e aplikimit, kandidati ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për masa disiplinore” datë 08.02.2021, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: “Nuk kam masë disiplinore në fuqi”.

28. Sipas informacionit të rikërkuar dhe përcjellë në rrugë elektronike nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidati z. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

29. Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, nuk vërtetohet që kandidati z. {...} të ketë masë disiplinore në fuqi.

30. Për kandidatin z. {...} u verifikua edhe kriteri i “papajtueshmërisë ambientale”.

31. Papajtueshmëria ambientale si kriter ndalues për ngritjen në detyrë edhe në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, që gjen reflektim në shkronjën “d”, të pikës 5, të Vendimit të Këshillit nr. 30, datë 25.01.2021, është parashikuar në nenin 8, pika 2, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “Këshillat, gjatë ... ngritjes në detyrë të magjistratit, për aq sa është e mundur dhe pa cënuar në mënyrë jopropocionale të drejtën për zhvillimin normal të karrierës profesionale të magjistratit, marrin masa për të shmangur papajtueshmërinë ambientale, sipas pikës 3, të këtij neni, me qëllim që të garantohet besimi i publikut në sistemin e drejtësisë, pavarësia dhe paanësia e magjistratit, eficienta e gjykatave dhe zyrave të prokurorisë në dhënien e drejtësisë”. Ndërkohë, kuptimi i papajtueshmërisë ambientale përcaktohet në pikën 1, të kësaj dispozite ligjore, sipas të cilës: “Papajtueshmëria ambientale, në kuptimin e këtij neni, krijohet për shkak të lidhjeve të ngushta familjare mes magjistratëve, që janë përkatësisht bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë”. Sa i takon rasteve të papajtueshmërisë ambientale për sa lidhet me ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ato parashikohen në pikën 3, shkronja “a”, të kësaj dispozite ligjore, ku përcaktohet se: “Papajtueshmëria ambientale përbëjnë rrethanat e mëposhtme: a) nëse respektivisht në të njëjtën gjykatë ose prokurori ku magjistrati kërkon të caktohet, ushtron funksionin një magjistrat tjetër, që ndodhet në kushtet e pikës 1 të këtij neni”.

32. Në lidhje me papajtueshmërinë ambientale, në rastin e aplikimit, në përputhje me detyrimin sipas nenit 8, pika 5, të Ligjit për Statusin, kandidati ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për situatën e papajtueshmërisë ambientale” datë 08.02.2021, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: “Nuk do të ndodhem në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.

33. Gjatë verifikimit nuk rezultoi ndonjë e dhënë e ndryshme nga ajo e deklaruar nga kandidati në lidhje me situatën e papajtueshmërisë ambientale për sa ai kandidon për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

34. Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, për kandidatin z. {...} nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

III. KONKLUZIONE

35. Referuar kërkesave të Vendimit 75/2019, duke mbajtur parasysh edhe përcaktimet e Vendimit nr. 30, datë 25.01.2021, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit paraprak të katër kriterëve formale të kandidimit të z. {...}, për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

36. Bazuar në sa më lart është parashtruar mbi rezultatet e verifikimit paraprak të katër kriterëve formale të kandidimit për kandidatin z. {...}, konkretisht të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “dhënies së pëlqimit për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidati i plotëson ato, ndërsa nuk ekziston ndonjë shkak për skualifikimin e tij nga kandidimi në lidhje me këto kriterë. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për verifikimin e plotësimin nga kandidati z. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të katër kriterëve të sipërpërmendura të kandidimit dhe vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë, të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 30, datë 25.01.2021.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur mbështetur në pikën 4 të nenit 135, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 8, në shkronjën “b” të pikës 2 dhe në pikën 3 të nenit 47, në pikën 7 të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, në pikën 9, të Vendimit të tij nr. 30, datë 25.01.2021, “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin

dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”, si dhe në Vendimin nr. 77, datë 04.03.2021, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 30, datë 25.01.2021, të Këshillit” Këshilli i Lartë Gjyqësor,

V E N D O S I :

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 30, datë 25.01.2021, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “dhënies së pëlqimit për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.
2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 30, datë 25.01.2021.
3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR